



Përshkrimi i produktit

Aero-Therm® për dyshemetë është një masë patinuese termoizoluese, e cila me veoritë e saj ndikon në rendimentin termik të ndërtesave. Ajo izolon dhjetë e dyshemeve dhe redukton thithjen e nxehtësisë prej tyre.

Veçoritë: Aero-Therm® për dyshemetë formon në një sipërfaqe prej 1 mm një shtresë kompakte elastike, e cila është në kontakt të plotë e pa zgavra ajri me dyshemën. Struktura e masës patinuese ka në përbërje lëndë mbushëse dhe lidhëse. Ajo është e pasuruar dhe me lëndë të tjera përbërëse. Falë veçorive të saj specifike, në rastin e përdorimit të veshjeve të buta të dyshemeve, nuk është e nevojshme që të përdoren shtresa të tjera përforcuese mbrojtëse.

Udhëzimi i përdorimit

Aero-Therm® për dyshemetë kërkon një sipërfaqe kohezive dhe të qëndrueshme, pa vajra apo lubrifikante, pluhur, papastërti dhe myqe. Aero-Therm për dyshemetë nuk mund të përdoret mbi një sipërfaqe, e cila është vazhdimisht e lagësht, p.sh. për shkak të efektit të lagështisë nga kapilariteti, dëmtime në hidroizolim etj.

Rregullat e përdorimit

Vendosja e shtresës së Aero-Therm® për dyshemetë duhet të jetë kudo uniforme. **Kujdes!** Nuk duhet të krijohen hapësira në material apo ulje të trashësisë së shtresës! Për të shmangur urat termike dhe krijimin e myqeve duhet të shtrohet dhe një shtresë në anët e mureve me lartësi prej 1,5 herë të trashësisë së murit.

Shtrimi me mallë të dhëmbëzuar

Për shtrimin e një sipërfaqeve të madha dhe të rrafshta përdoret një mallë pa ndryshk me dhëmbë prej 6 mm. Së pari shtrohet masa me anën e dhëmbëzuar të mallës, më pas rrafshohet ajo me anën e drejtë të saj, në mënyrë që të mos krijohen pabarazi ose kurrize, sepse më pas është shumë e vështirë që materiali të zmerilohet. Është e rëndësishme ti kushtohet një vëmendje e veçantë këndeve, cepave dhe detajeve të tjera, të cilat e bëjnë vështirë të dallueshëm mbivendosjen në sipërfaqet ngjitur me to.

Sprucimi

Aero-Therm® për dyshemetë duhet të hollohet në atë mënyrë që materiali të rrjedhë si mjaltë. Rrjedhja gjatë mbushjes së enës sprucuese nuk duhet të ndërpritet. Për sprucimin mund të përdoret paisje me presion të ulët, por dhe ato me presion të lartë.

Derdhja

Nëse dyshemeja nuk është e rrafshët materiali mund të hollhet në atë masë sa që derdhja dhe shpërndarja të jetë e mundur. Pas derdhjes materiali shpërndahet uniformisht me një mallë pa ndryshk me dhëmbë prej 6 mm, pastaj me ndihmën e një ruli me gjemba të krijoni një shtresë uniforme dhe më pas lëreni të univermizohet vetë. Në rastin e një përdorimi të tillë duhet të materiali të jetë i holluar dhe si pasojë koha e tharjes më e gjatë.

Përpunimi i sipërfaqeve

Shtresëzimet: kontaktoni me prodhuesit nëse ky material është i përshtatshëm për hedhjen mbi të Aero-Therm® për dyshemetë.

Pllakat dhe linoleumet: mbi materialin ngjites që do të përdorni në këtë arst bisedoni me prodhuesin e tij.

Qilima dhe dysheme të lëvizshme (parket apo laminate):

qilimat mund të shrohen direkt mbi Aero-Therm® për dyshemetë. Në shtresat e lëvizshme të dyshemeve (parket apo laminate)ne rekomandojmë të vendosen shtresa për amortizimin e peshave.

Ngryhja e dyshemeve: Aero-Therm® për dyshemetë, falë veçorive të tij, është i përshtatshëm të vendoset poshtë sistemeve ngrohëse lelektrike apo me ujë të ngrohtë të dyshemeve. Ne rekomandojmë që para shtrimit të Aero-Therm® të kontaktohet me prodhuesin.

Udhëzim: Prodhuesi nuk ka përgjegjësi për përdorime të Aero-Therm® për dyshemetë, të cilat nuk janë bërë nga një firmë e specializuar.

Temperatura e përdorimit dhe koha e tharjes

Temperatura e rekomanduar e ajrit dhe e dyshemesë gjatë shtresëzimit duhet të jetë +5C deri +25C. Koha e tharjes varet nga temperatura e mjedisit, e dyshemesë dhe lagështia relative e ajrit. Koha mesatare e tharjes është rreth 20 orë. Aero-Therm® për dyshemetë polimerizohet duke u nisur nga sipërfaqja në dysheme.

Rendimenti:

• Në shtresëzimin mbi një sipërfaqe prej 1m nevojitet 1 litër Aero-Therm® për dyshemetë. Në rastin e metodës me sprucim ka një humbje prej 10% për m .

Pastrimi i veglave të punës: mjafton që veglat e punës të shpëlahen me ujë. Nëse materiali është tharë ai mund të shpëlahet me ujë të ngrohtë.

Transporti dhe makazini: gjatë transportit dhe makazinit materiali duhet të mbahet në temperatura nga +5C deri në +25C. Mbrojeni atë nga kontakti i drejtëpërdrejtë me rrezet e diellit dhe temperaturat e larta. Koha e skadimit 2 vjet në paketim original të pahapur. Materiali i pa përdorur mund të ruhet i paholluar për 6 muaj. **Aero-Therm® për dyshemetë nuk duhet të ngrijë!!!**

Siguria e higjensë dhe punës: Ky produkt nuk klasifikohet dhe as shënohet si i dëmshëm për shëndetin. Gjatë përdorimit nuk duhet të hani, pini lëngje apo duhan. Në rastin e gjëllitjes pini afërsisht 1 litër ujë dhe provokoni të vjellit. Përdorni mjete personale për mbrojtje e syve dhe të fytyrës. Gjatë sprucimit dhe zmerilimit përdorni maska frymëmarrje kundër pluhurit si dhe syze ose mbrojtëse fytyre. Në rastin e kontaktit me sytë shplajni atë menjëherë me ujë. Pas punës lajini duart me ujë të ngrohtë dhe sapun dhe trajtojini ato me kremra të ripërtëritjes së lëkurës. Ruajeni materialin vetëm në paketimin origjinal.

Flakja e materialit: Hedhja e materialit në plehra duhet të kryhet në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi

Flakja e paketimit: Paketimi duhet të zbrazet krejtësisht për t'iu nënështuar ricklimit.

1 Litër 1 ≥ m²

12 Litra



Distributor:
Recycling Group
Mob. 0665740500
recycling.group@yahoo.com

8595603700324